UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I EDUKIMIT

Rr. Agim Ramadani, Fakulteti i Edukimit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 38 229 201 • E-mail: edukimi@uni-pr.edu • edukimi.uni-pr.edu

# Zbatimi i Kornizës së Kurrikulës së Kosovës

### *Qëllimi i programit:*

Ky modul ofrohet është dizajnuar me mbështjeten e projektit EU IPA 2009 "Trajnimi i mësimdhënësve dhe ndërtimi i kapaciteteve të komunave dhe drejtorë të shkollave" i financuar nga BE menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë (ZBE) dhe zbatuar në emër të MASHT-it nga GIZ IS. Në kuadër të marrëveshjes së Fakultetit të Edukimit/IHZHA dhe MASHT është paraparë ofrimi i trajnimeve për zhvillim profesional të mësimdhënësve dhe ky modul parashihet të ofrohet me qëllim të zhvillimit të kulturës së bashkëpunimit në mes të kolegëve sa i përket zbatimit të reformës kurrikulare.

### *Grupi i synuar i mësimdhënësve /vijuesve :*

Ky program i dedikohet mësimdhënësve të klasave 1-12 të të gjitha fushave, gjithashtu edhe studentëve, të cilët janë duke u përgatitur si mësimdhënës të ardhshëm.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim është 15-25.

### *Rezultatet e programit:*

Në fund të punës me module dhe aktivitete tjera mësimdhënësit do të jenë në gjendje të:

- Kuptojnë reformën kurrikulare
- Identifikojnë sfidat e reformës kurrikulare
- Identifikojnë veprimet që nevojiten për plotësimin e nevojave të kurrikulës së re
- Zhvillojnë plane dhe programe për kurrikulën e reformuar dhe lëndët zgjedhore.